

RAPORT / REPORT

MONITORIMI I PERFORMANCËS SË QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT

MONITORING THE PERFORMANCE OF THE NATIONAL REGISTRATION CENTER



RAPORT

**MONITORIMI I PERFORMANCËS
SË QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT**



Përgatitur nga Partnerët Shqipëri
për Programin Prag të Korporatës së Sfidës
së Mijëvjeçarit për Shqipërinë II

Qershor 2010

Ky raport u realizua me mbështetjen e Popullit Amerikan përmes Programit Prag të Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë II (MCCA2), i cili administrohet nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). *Partnerët Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti* mban përgjegjësi të plotë për brendinë e këtij raporti, i cili nuk përfaqëson detyrimisht pikëpamjet e Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit, USAID-it, apo të qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Falenderime të veçanta për MCCA2 për mbështetjen e tyre, si dhe për përfaqësuesit e biznesit që morën pjesë në këtë studim. Autorët vlerësojnë shumë gatishmërinë e tyre për të kontribuar në të.

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Përmbledhje ekzekutive	8
Rezultatet e përgjithshme	8
Rezultatet e zyrës qendrore	9
Rezultatet në sportelet në bashki	9
2. Hyrje	10
3. Metodologjia	11
3.1 Objektivat e vrojtimit	11
3.2 Përshkrimi i kampionit	12
4. Gjetjet nga pyetëtori	13
4.1 Gjetjet e përgjithshme	13
4.2 Gjetjet mbi performancën e shërbimeve	16
4.3 Dhënia e informacionit	22
4.4 Procedurat e ankimimit	25
5. Pyetëtori	27

TABELA E GRAFIKËVE

<u>Grafik 1:</u> Arsyeja për të vizituar QKR-në	13
<u>Grafik 2:</u> Lloji i shërbimeve të kërkuara	14
<u>Grafik 3:</u> Kampioni sipas llojit të biznesit	14
<u>Grafik 4:</u> Kampioni sipas marrëdhënies me biznesin	15
<u>Grafik 5:</u> Gjinia e të intervistuarve	15
<u>Grafik 6:</u> Vërtetimi i dhënë në kohën e dorëzimit të aplikimit	16
<u>Grafik 7:</u> Koha për të marrë përgjigje	16
<u>Grafik 8:</u> A janë të qarta procedurat e aplikimit?	17
<u>Grafik 9:</u> PAGESA PËR SHËRBIMIN E MARRË	17
<u>Grafik 10:</u> Koha e shpenzuar për të marrë shërbim	18
<u>Grafik 11:</u> Koha e shpenzuar e krahasuar me vizitën e mëparshme	18
<u>Grafik 12:</u> Vlerësimi i përgjithshëm i shërbimeve të QKR-së	19
<u>Grafik 13:</u> Vlerësimi i përgjithshëm i shërbimeve të QKR-së sipas gjinisë së të intervistuarit	19
<u>Grafik 14:</u> Numri i vizitave për të dorëzuar një aplikim sipas vendndodhjes	20
<u>Grafik 15:</u> Numri i vizitave për të dorëzuar një aplikim sipas llojit të shërbimit	20
<u>Grafik 16:</u> Numri i vizitave për të marrë përgjigje/çertifikatën sipas vendndodhjes	21
<u>Grafik 17:</u> Numri i vizitave për të marrë përgjigje/çertifikatën sipas llojit të shërbimit	21
<u>Grafik 18:</u> Mjaftueshmëria e informacionit	22
<u>Grafik 19:</u> Burimi i informacionit rreth QKR-së	22
<u>Grafik 20:</u> Përdorimi i faqes së internetit të QKR-së	23
<u>Grafik 21:</u> Faqja e internetit të QKR-së ofron informata të dobishme dhe të mjaftueshme	23
<u>Grafik 22:</u> Faqja e internetit të QKR-së është e qartë dhe e lehtë për t'u kuptuar	24
<u>Grafik 23:</u> Si mund të përmirësohet faqja e internetit të QKR-së?	24
<u>Grafik 24:</u> Procedurat e ankimimit	25
<u>Grafik 25:</u> A ofroi stafi i QKR-së ndihmë/mbështetje të mjaftueshme?	25
<u>Grafik 26:</u> Mënyra e trajtimit të ankesave nga stafi i QKR-së	26

1. Përmbledhje

Ligji i ri për regjistrimin e biznesit u miratua nga Parlamenti në 3 maj 2007. Ligji nr. 9723 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” themeloi Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) si një institucion i ri publik në nivel të qeverisë qendrore. Qendra Kombëtare e Regjistrimit filloi veprimtarinë më 3 shtator 2007 dhe, përveç selisë së saj në Tiranë, QKR ka 29 sportele shërbimi në bashki. Zyrat e Regjistrimit të vendosura në të gjithë Shqipërinë i krijojnë mundësi biznesit të përfundojë të gjitha procedurat e regjistrimit në nivel vendor.

Krijimi i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) përmirësoi në mënyrë drastike procesin e regjistrimit të biznesit në Shqipëri. Kjo reformë ishte një hap i rëndësishëm në arritjen e qëllimit të përgjithshëm të qeverisë për përmirësimin e klimës së biznesit. Ajo solli përfitime të rëndësishme për bizneset shqiptare dhe investitorët e huaj: një proces më të thjeshtë, më të shpejtë dhe më pak të kushtueshëm për regjistrimin e një biznesi të ri.

Ky raport paraqet rezultatet e studimit “Monitorimi i punës së QKR-së në ofrimin e shërbimeve”, administruar nga Partnerët Shqipëri në periudhën nëntor 2009 - prill 2010.

Rezultatet e përgjithshme

- Shumica e të intervistuarve morën përgjigje për aplikimin e bërë ose morën çertifikatën e regjistrimit të biznesit brenda 24 orësh nga momenti i paraqitjes së kërkesës së tyre. Përqindjet për këtë tregues janë paksa të ndryshme në zyrën qendrore të QKR-së (86%) krahasuar me sportelet në bashki (80%).
- Procedurat e aplikimit janë shumë të qarta për të gjithë të intervistuarit (deri në 93%) dhe ky rezultat nuk ndryshon në mënyrë të konsiderueshme në varësi të vendndodhjes së biznesit ose llojit të të intervistuarit.
- Më shumë se 90% e të intervistuarve i vizituan sportelet e QKR-së jo më shumë se dy herë për të marrë përgjigje ose për të marrë çertifikatën e regjistrimit. Kjo është e lidhur me faktin që procedurat ishin të qarta dhe stafi i QKR-së punonte me efikasitet.
- Shumica dërrmuese e të intervistuarve deklaruan se shpenzuan më pak se tridhjetë minuta për të marrë shërbim dhe koha e shpenzuar në sportelet e shërbimit të QKR-së ishte më e vogël ose e barabartë me kohën e shpenzuar gjatë vizitës së tyre të mëparshme në QKR.
- Rezultatet e studimit treguan një nivel të lartë të kënaqësisë në lidhje me performancën e përgjithshme të shërbimeve të ofruara nga QKR-ja. Më shumë se 90% e të intervistuarve të të dy gjinive e përcaktuan nivelin e kënaqësisë nga këto shërbime si të mirë ose shumë të mirë.

- Shumicës së të intervistuarve ju desh t'i vizitonte sportelet e shërbimit të QKR-së vetëm një herë për të paraqitur aplikimin, ndërsa 20% e të intervistuarve e vizituan QKR-në dy herë për të paraqitur një aplikim.
- Pjesa dërmuese e të intervistuarve i vizituan sportelet e shërbimit të QKR-së jo më shumë se dy herë për të marrë përgjigje apo për të marrë çertifikatën. Megjithatë, 31% e të intervistuarve, të cilët kishin aplikuar për të çregjistruar biznesin të tyre, e kanë vizituar QKR-në më shumë se dy herë.
- Pjesa dërmuese e të intervistuarve në të gjitha sportelet e shërbimit të QKR-së e konsiderojnë informacionin e dhënë nga QKR-ja si të mjaftueshëm. Broshura/botimet e QKR-së dhe faqja e saj e internetit mbeten burimet e preferuara të informacionit mbi procedurat e aplikimit në QKR.
- Shumica e të intervistuarve (83%), të cilët përdorin faqen e internetit të QKR-së, mendojnë se kjo faqe interneti ofron informacion të qartë dhe të lehtë për t'u kuptuar, ndërsa 76% e të intervistuarve thanë se informacioni i dhënë nga faqja e internetit të QKR-së është i dobishëm dhe i mjaftueshëm.

Rezultatet në zyrën qendrore të QKR-së

- Në përgjithësi, stafi në zyrën qendrore të QKR-së ofron shërbime më të shpejta se stafi në sportelet në bashki.
- 49% e të intervistuarve thanë se broshura dhe botimet e QKR-së mbeten mënyra më e mirë për të marrë informacion mbi procedurat e regjistrimit.
- 59% e të intervistuarve në zyrën qendrore të QKR-së e merre informacionin përmes faqes së internetit të QKR-së.
- Pjesa dërmuese e të intervistuarve në zyrën qendrore të QKR-së (82%) që kishin paraqitur ankesa, thanë se paraqitja e ankesës është e lehtë ose shumë e lehtë.
- 82% e të intervistuarve deklaruan se stafi në zyrën qendrore të QKR-së i ka trajtuar ankesat e tyre mirë dhe shumë mirë.

Rezultatet në sportelet e shërbimit në bashki

- 12% e të intervistuarve në sportelet në bashki i vlerësuan shërbimet e QKR-së si të këqija. Ky vlerësim është shpërndarë në mënyrë uniforme ndër të gjitha sportelet në bashki.
- Vetëm 18% e të intervistuarve në sportelet në bashki thanë se mënyra më e mirë për të marrë informacion mbi procedurat e regjistrimit është faqja e internetit të QKR-së.
- Vetëm një e treta e të intervistuarve në këto sportele përdorin faqen e internetit të QKR-së për të marrë informacion.
- 38% e të intervistuarve në sportelet e shërbimit në bashki thanë se ankesat e tyre janë trajtuar disi apo keq nga ana e stafit të QKR-së.

2. Hyrje

Një nga nismat kryesore të ndërmarra nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) ishte dhe reforma në procedurat e regjistrimit të biznesit, duke e ulur tarifën në ngarkim të aplikantëve në 100 lekë, duke e reduktuar kohën e nevojshme për të regjistruar një biznes të ri në një ditë dhe duke i kombinuar të gjithë hapat e regjistrimit në një procedurë të vetme, përfshirë dhe regjistrimin në administratën tatimore.

Ligj i ri mbi reformën në regjistrimin e biznesit u miratua nga Parlamenti në 3 maj 2007. Ligji nr. 9723 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” themeloi Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) si një institucion i ri publik qendror. Ligji i ri dhe krijimi i QKR-së ishin nisma të Qeverisë së Shqipërisë dhe METE-s, të cilat u përkrahën nga faza e parë e Programit Prag të Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë.

Kjo reformë ishte një hap domethënës në kuadrin e programit të qeverisë për përmirësimin e klimës së biznesit në Shqipëri. Reforma ofron disa përfitime të rëndësishme, si për bizneset shqiptare, ashtu edhe për investitorët e huaj: një proces më të thjeshtë, më të shpejtë dhe me më pak shpenzime për regjistrimin e bizneseve të reja, si dhe regjistrim të njëkohshëm në administratën tatimore, në sigurimet shoqërore, në sigurimet shëndetësore dhe në Inspektoriatin e Punës, nëpërmjet përdorimit të një procedure të vetme aplikimi.

Sportelet e shërbimit të QKR-së janë të vendosura në të gjithë Shqipërinë, duke bërë të mundur që një biznes të përfundojë të gjitha procedurat e regjistrimit në nivel vendor. QKR-ja filloi veprimtarinë më 3 shtator 2007 dhe, përveç zyrës qendrore në Tiranë, QKR-ja ka sportele shërbimi në 29 bashkitë në vijim: Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Korçë, Shkodër, Fier, Gjirokastër, Krujë, Rrëshen, Berat, Bulqizë, Kavajë, Lushnjë, Pogradec, Çorovodë, Librazhd, Burreli, Bajram Curri, Gramsh, Peshkopi, Tepelenës, Laç, Lezhë, Ersekë, Përmet, Pukë, Sarandë, Kukës, si dhe në dhomat e tregtisë në Tiranë dhe Durrës.

Publiku ka akses falas në informacionin e Regjistrimit Tregtar, i cili gjendet në faqen në internet të QKR-së. Të gjitha sportelet e shërbimit pranojnë aplikime dhe janë të lidhura përmes internetit me regjistruarit në zyrën qendrore të QKR-së, e cila miraton aplikimin brenda një dite, pasi merr një aplikim të plotësuar siç duhet në një sportel shërbimi. Formularët e aplikimit dhe udhëzimet gjenden në faqen në internet të QKR-së (www.qkr.gov.al) ose në çdo sportel shërbimi të QKR-së. Regjistrimi në QKR siguron, gjithashtu, regjistrim të njëkohshëm në administratën tatimore, si dhe regjistrimin për sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore, me Inspektoriatin e Punës dhe me administratën tatimore në bashkinë përkatëse.

3. Metodologjia

3.1 Objektivat e studimit

Objektivi i këtij studimi ishte të vlerësonte shërbimet e QKR-së nga pikëpamja e njëtrajshmërisë, cilësisë, profesionalizmit, transparencës, drejtësisë dhe efektivitetit. Ky studim vlerësoi, gjithashtu, bashkëveprimin e QKR-së me agjenci të tjera qeveritare shumë të rëndësishme për komunitetin e biznesit në Shqipëri, të tilla si Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Inspektoriati i Punës.

Monitorimi u fokusua në:

- të gjitha shërbimet e QKR-së, të specifikuara në ligjin e QKR-së, mbi procedurat e regjistrimit të biznesit, d.m.th., regjistrimi i një biznesi të ri, ndryshimet në të dhënat e regjistrimit të biznesit, lëshimi i ekstrakteve ose i çertifikatave të tjera, regjistrimi i mbylljes së një biznesi, përgjigje për pyetjet apo plotësimi i kërkesave për informacion, regjistrimi dhe trajtimi i ankesave;
- të gjitha fazat e ofrimit të shërbimeve në sportelet e shërbimit të QKR-së, nga marrja e dokumentacionit deri tek dhënia e çertifikatave;
- përvojën e klientëve në sportelet e shërbimit dhe në përdorimin e faqes së internetit të QKR-së, nga pikëpamja e aksesit, lehtësisë në përdorim dhe trajtimin të përshtatshëm të klientëve;
- ndërveprimin e QKR-së me agjencitë e tjera qeveritare.

Për të realizuar monitorimin e QKR-së, u përdorën mjetet e mëposhtme të hulumtimit:

- Intervista në dalje me persona që aplikojnë në QKR - Partnerët Shqipëri, me përkrahjen e Programit Prag të Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë II, zhvilluan dhe administruan një anketim me klientët e QKR-së në momentin që ata sapo kishin dalë nga një sportel i QKR-së. U realizuan në total 1014 intervista.
- 50 intervista në thellësi me stafin e QKR-së, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si dhe me përfaqësuesit e bashkive. Partnerët Shqipëri, në bashkëpunim me Programin Prag të Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë II, hartuan tri grupe pyetjesh. Qëllimi i këtij mjeti ishte: (i) të sigurohej informacion specifik sasior dhe cilësor nga një kampion i zyrtarëve të QKR-së dhe i institucioneve të tjera, (ii) të merrej një spektër njohurish të ndryshme për çështje specifike.
- Fokus grupet – Diskutimet në fokus grupe bënë të mundur një shkëmbim të gjerë mendimesh me klientët QKR-së. Kjo shërbeu për t'i vënë në kontekst të dhënat e nxjerra përmes pyetësorit dhe për të shpjeguar tendencat e vëzhguara, si dhe ndihmoi në nxjerrjen e përfundimeve të argumentuara mirë. Fokus grupet, të cilat shërbyen për të marrë reagime nga klientët e QKR-së dhe për të shqyrtuar problemet specifike të pazbuluara nga intervistat në dalje, u organizuan me klientë të QKR-së në Tiranë, Durrës, Vlorë dhe Shkodër.

- Vrojtme në terren për çdo sportel të QKR-së - Ky mjet u përdor për mbledhjen e të dhënave për çështje të veçanta, si vendndodhja, aksesit për klientët, informacioni mbi shërbimet e mundshme, sjellja e stafit të QKR-së, orari i punës, materiale promociionale në çdo sportel të QKR-së, etj.

3.2 Përshkrimi i kampionit

Kampioni ishte i përbërë nga 1014 klientë të QKR-së dhe u shpërnda sipas sporteve të QKR-së në qendër dhe në rrethe duke marrë në konsideratë shpërndarjen e numrit të klientëve të QKR-së në këto sporte në të kaluarën (bazuar në të dhënat e ofruara nga QKR-ja për periudhën janar - qershor 2009), si dhe zhvillimin ekonomik të çdo rrethi. Intervistat u zhvilluan në periudhën 28 dhjetor 2009 - 10 mars 2010.

Tabela 1: Përshkrimi i kampionit sipas vendndodhjes

	Vendndodhja e sporteve të shërbimit	Frekuenca	Përqindja
1	Zyra qendrore në Tiranë	395	39.0
2	Bashkia Tiranë	99	9.8
3	Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë	51	5.0
4	Bashkia Durrës/Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Durrës	90	8.9
5	Bashkia Elbasan	45	4.4
6	Bashkia Vlorë	49	4.8
7	Bashkia Fier	49	4.8
8	Bashkia Krujë	15	1.5
9	Bashkia Berat	30	3.0
10	Bashkia Gjirokastrë	21	2.1
11	Bashkia Kavajë	20	2.0
12	Bashkia Lushnjë	10	1.0
13	Bashkia Pogradec	20	2.0
14	Bashkia Shkodër	50	4.9
15	Bashkia Korçë	35	3.5
16	Bashkia Lezhë	20	2.0
17	Bashkia Sarandë	15	1.5
	Totali	1,014	100


Përafërsisht, 39% e intervistave u realizuan përmes intervistave ballë për ballë me klientë të QKR-së, pasi ata dilnin nga zyra qendrore e QKR-së në Tiranë, dhe pjesa tjetër u realizua në 17 sportelet në bashkitë e listuara më sipër. Marzhi i gabimit për kampionin prej 1014 të intervistuarish është $\pm 3\%$ me një interval besueshmërie prej 95%.

4. Gjetjet nga pyetëtori

Kjo pjesë e raportit paraqet gjetjet e hollësishme nga intervistat në dalje me klientët e QKR-së. Këto gjetje paraqiten pyetje pas pyetje, duke përfshirë kryqëzimin e vlerave të zgjedhura sipas llojit të biznesit, vendndodhjes së tij dhe sipas gjinisë së të intervistuarit.


4.1 Gjetjet e përgjithshme

Grafik 1: Arsyeja për të vizituar QKR-në (n=1014)



Rreth gjysma e të intervistuarve në nivel kombëtar vizitoi sportelet e shërbimit të QKR-së për të paraqitur një aplikim, 35% për të marrë një çertifikatë apo një përgjigje për aplikimin e tyre, dhe pjesa tjetër për të marrë informacion ose për të paraqitur një ankesë.


Grafik 2: Lloji i shërbimeve të kërkuara (n=894)



21% e të intervistuarve pranë zyrës qendrore të QKR-së deklaruan se ata e kishin vizituar QKR-në për të përfunduar regjistrimin fillestar të biznesit të tyre. Arsyeja e dytë më e shpeshtë për vizitë ishte aplikimi për të ndryshuar të dhënat e regjistrimit të biznesit (17%), si dhe aplikimi për të marrë një ekstrakt të thjeshtë (17%). Përveç kësaj, 13% e tyre aplikuan për të marrë një ekstrakt historik, 9% aplikuan për çregjistrim të biznesit dhe pjesa tjetër për lloje të tjera të shërbimeve.

Në sportelet në bashki, rreth një e treta e të intervistuarve (35%) e vizituan sportelin e QKR-së me synim regjistrimin fillestar të biznesit, 17% për të ndryshuar të dhënat e regjistrimit të biznesit, 13% për të marrë një ekstrakt dhe 11% për ta çregjistruar biznesin.


Grafik 3: Kampioni sipas llojit të biznesit (n=894)



Në nivel kombëtar, forma më e zakonshme e bizneseve të intervistuarra ishin persona fizikë (individë të vetëpunësuar, 52%), të pasuar nga kompanitë tregtare (45%). Pjesa tjetër përfshin shoqëritë e thjeshta, degë të kompanive të huaja, kompani të kursim/kredisë dhe subjekte të tjera, siç tregohet në Grafikon 3.

63% e të intervistuarve pranë zyrës qendrore të QKR-së përfaqësonin shoqëri tregtare, ndërsa vetëm 33% e të intervistuarve në sportelet në bashki përfaqësonin shoqëri tregtare.


Grafik 4: Kampioni sipas marrëdhënies me biznesin (n=894)



Në zyrën qendrore të QKR-së, ku aplikojnë më shumë shoqëritë tregtare, 50% e të intervistuarve ishin persona të autorizuar, por jo juristë, 7% ishin juristë të brendshëm të shoqërive dhe 6% përfaqësonin biznesin (studio ligjore). Vetëm 35% ishin aplikantë individualë që përfaqësonin veten e tyre, siç tregohet në Grafikon 4.

Në të kundërt, në sportelet në bashki, ku shumica e aplikantëve janë individë të vetëpunësuar, 74% e të intervistuarve ishin aplikantë individualë që përfaqësonin veten e tyre dhe 22% ishin persona të autorizuar, jo juristë, që përfaqësonin aplikantët.

Grafik 5: Gjinia e të intervistuarve (n=1014)




Shumica e të intervistuarve në zyrën qendrore të QKR-së dhe në sportelet në bashki ishin meshkuj.

4.2 Gjetjet mbi performancën e shërbimeve


Kjo pjesë e studimit përqendrohet në performancën e shërbimeve të ofruara nga sportelet e shërbimit të QKR-së. Të intervistuarit ju përgjigjën pyetjeve lidhur me performancën e QKR-së bazuar në përvojat individuale me procedurat e aplikimit në këtë institucion.

Grafik 6: Vërtetimi i dhënë në kohën e dorëzimit të aplikimit (n=894)




Shumica dërmuese e të intervistuarve (93%) thanë se morën një vërtetim kur paraqitën aplikimin e tyre. Rezultatet e studimit treguan se kjo përqindje ishte disi më e ulët (90%) në zyrën qendrore të QKR-së. Duhet të theksohet se QKR-ja nuk ka detyrim të lëshojë vërtetim për pranimin e aplikimit.

Grafik 7: Koha për të marrë përgjigje (n=353)




Shumica e të intervistuarve (83%) në nivel kombëtar morën përgjigje ose morën çertifikatën e regjistrimit të biznesit brenda 24 orëve dhe rezultatet për këtë tregues mes zyrës qendrore të QKR-së dhe sporteleve në bashki ndryshojnë vetëm pak. Në përgjithësi, të gjitha sportelet e QKR-së janë në gjendje që të japin brenda 24 orëve shumicën e shërbimeve të tilla si regjistrimi fillestar dhe lëshimi i ekstraktit nga Regjistri Tregtar.

Grafik 8: A janë të qarta procedurat e aplikimit? (n= 894)




Siç shihet në Grafikon 8, 95% e të intervistuarve thanë se procedurat e aplikimit janë të qarta dhe ky rezultat nuk ndryshon shumë në varësi të vendndodhjes apo tipit të të intervistuarit.

Grafik 9: Paguesa për shërbimin e marrë (n=894)




Të gjithë aplikantët në zyrën qendrore të QKR-së paguan vetëm 100 lekë për t'i marrë shërbimet. Vetëm 1% e të intervistuarve në sportelet në bashki u përgjigjën se paguan më shumë se 100 lekë. 8 të intervistuar kanë thënë se kanë paguar më shumë se 100 lekë, 4 nga të cilët në sportelin e QKR-së në Vlorë, 2 në Durrës, 1 në Fier dhe 1 në Pogradec. Disa nga arsyet pse ata paguan më shumë janë si vijon: sepse dëshironin ta bënin këtë gjë, nuk kishin kohë të prisin për të marrë kusur ose nëpunësi i QKR-së nuk kishte të holla për t'iu kthyer.

Grafik 10: Koha e shpenzuar për të marrë shërbimin (n=894)




Shumica dërmuese e të intervistuarve pohuan se pritën më pak se tridhjetë minuta për të marrë shërbim. Në përgjithësi, zyra qendrore e QKR-së duket se ofron shërbim më shpejt se sportelet në bashki.

Grafik 11: Koha e shpenzuar krahasuar me vizitën e mëparshme (n=638)




Mbi 90% e të intervistuarve pohuan se koha e shpenzuar me nëpunësin e sportelit të QKR-së ishte më e shkurtër ose e barabartë me kohën e shpenzuar gjatë vizitës së tyre të mëparshme në atë sportel të QKR-së. Kjo tregon përmirësimin e performancës së sporteleve të QKR-së, të cilat kanë arritur të shkurtojnë kohën e nevojshme për një aplikim. Ky rezultat vë në dukje, gjithashtu, nevojën për përmirësim të mëtejshëm në disa sportele në bashki, në mënyrë që të zvogëlohet koha që klientët shpenzojnë me nëpunësin e QKR-së.

Grafik 12: Vlerësimi i përgjithshëm i shërbimeve të QKR-së (n=894)




91% e të intervistuarve në shkallë kombëtare e vlerësuan nivelin e përgjithshëm të shërbimeve të ofruara nga stafi i sporteleve të QKR-së si të mirë ose shumë të mirë. Në përgjithësi, rezultatet e studimit treguan një nivel të lartë kënaqësie të klientëve të QKR-së me shërbimin e ofruar në sportelet e këtij institucioni, por ka pasur gjithashtu dhe një përqindje të konsiderueshme (12%) të të intervistuarve në sportelet në bashki, të cilët kanë deklaruar se shërbimi ishte disi ose i keq. Ky vlerësim i fundit është shpërndarë uniformisht ndër të gjitha sportelet në bashki.

Grafik 13: Vlerësimi i përgjithshëm i shërbimeve të QKR-së sipas gjinisë së të anketuarit (n=894)




Nuk ka ndonjë dallim të madh në mes të të intervistuarve meshkuj dhe femra në lidhje me nivelin e kënaqësisë për shërbimet e ofruara nga sportelet e QKR-së. Së paku 90% e të intervistuarve të të dy gjinive e përcaktuan nivelin e kënaqësisë nga këto shërbime si të mirë ose shumë të mirë.

Grafik 14: Numri i vizitave për të dorëzuar një aplikim sipas vendndodhjes (n=540)




Për të paraqitur aplikimin e tyre, rreth tri të katërtat e të intervistuarve i vizituan zyrën qendrore të QKR-së dhe sportelet në bashki vetëm një herë, ndërsa rreth 20% e vizituan QKR-në dy herë. Rezultatet ndryshonin vetëm pak mes zyrës qendrore të QKR-së dhe sporteleve në bashki.

Grafik 15: Numri i vizitave për të dorëzuar një aplikim sipas llojit të shërbimit (n=531)




Shumica e të intervistuarve i vizituan sportelet e QKR-së vetëm një herë për të paraqitur kërkesën e tyre për shërbime si ekstrakt i thjeshtë dhe historik. Megjithatë, më shumë se 25% e të intervistuarve i vizituan sportelet e QKR-së dy herë për të paraqitur një kërkesë për shërbime si çregjistrimi, korrigjimi i të dhënave në regjistër, aktivizim aktiviteti dhe regjistrim fillestar.

Grafik 16: Numri i vizitave për të marrë përgjigje/çertifikatë sipas llojit të shërbimit (n=354)



Më shumë se 90% e të intervistuarve duhet të bënin vetëm një ose dy vizita në sportelin e QKR-së për të marrë përgjigjen/çertifikatën. Nuk ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm mes zyrës qendrore të QKR-së dhe sporteleve në bashki lidhur me këtë tregues. Klientët e QKR-së dhanë arsye të ndryshme pse vizituan QKR-në më shumë se dy herë për të marrë përgjigje. Numri i vizitave nuk është i lidhur me procedurën e vonuar apo me ndonjë shërbim të veçantë.

Grafik 17: Numri i vizitave për të marrë përgjigje/çertifikatë sipas llojit të shërbimit (n=302)




Shumica e të intervistuarve i vizituan sportelet e QKR-së jo më shumë se dy herë për të marrë përgjigjen/çertifikatën për shërbime të tilla si regjistrim fillestar, ekstrakt i thjeshtë dhe historik. Për aplikimet për çregjistrim të biznesit, 31% e të intervistuarve duhej ta vizitonin QKR-në më shumë se dy herë për të marrë përgjigjen/çertifikatën.

4.3 Dhënia e informacionit


Kjo pjesë e studimit përqëndrohet në informacionin e dhënë nga QKR-ja, burimet e informacionit dhe përvojat e klientëve që përdorin faqen e internetit të QKR-së, nga pikëpamja e mundësisë për ta marrë këtë informacion dhe lehtësisë për ta përdorur atë.

Grafik 18: Mjaftueshmëria e informacionit (n=997)




Shumica dërmuese e të intervistuarve në të gjitha sportelet e shërbimit të QKR-së e konsiderojnë informacionin e dhënë nga QKR-ja si të mjaftueshëm.

Grafik 19: Burimi i informacionit mbi QKR-në (n=991)




Të intervistuarit marrin informacion në lidhje me procedurat e QKR-së përmes burimeve të shumëllojshme, duke përfshirë botime dhe broshura të QKR-së, faqja e internetit të QKR-së, autoritetet tatimore, pushteti vendor dhe miqtë. Broshura e QKR-së përmendet më shpesh si burim informacioni nga aplikantët në zyrën qendrore të QKR-së (49%), sesa në sportelet në bashki (28%). Faqja e internetit konsiderohet si burim informacioni për rreth një të tretën e të intervistuarve në Tiranë, por vetëm 18% e të intervistuarve në sportelet në bashki e përdorin faqen e internetit si burim informacioni. Zyrat e informimit në bashki përmenden më shpesh si burim informacioni nga të intervistuarit në sportelet në bashki (20%), sesa në selinë qendrore të QKR-së.

Grafik 20: Përdorimi i faqes së internetit të QKR-së (n=957)




Shumica e të intervistuarve në selinë qendrore të QKR-së (59%) e përdorin faqen e internetit të QKR-së për të marrë informacion. Kjo përqindje është dukshëm më e ulët për të intervistuarit në sportelet në bashki (33%).

Grafik 21: Faqja e internetit të QKR-së ofron informata të dobishme dhe të mjaftueshme (n=416)




Shumica e të intervistuarve (76%), të cilët e përdorin faqen e internetit të QKR-së, thanë se informacioni i ofruar përmes saj është i dobishëm dhe i mjaftueshëm.

Grafik 22: Faqja e internetit të QKR-së është e qartë dhe e lehtë për t'u kuptuar (n=416)



Shumica e të intervistuarve (83%), të cilët e përdorin faqen e internetit të QKR-së, mendojnë që informacioni që ajo përmban, është i qartë dhe i lehtë për t'u kuptuar.

Grafik 23: Si mund të përmirësohet faqja e internetit të QKR-së? (n=411)




Të intervistuarit u pyetën se si mund të përmirësohet faqja e internetit të QKR-së. Përgjigja e zgjedhur më shpesh ishte “të përditësohet më shpesh” (36%), e ndjekur nga “(të ofrohet) më shumë informacion” (30%), “duhet të jetë më e lehtë për të gjetur informacione të rëndësishme, për të cilat kam nevojë” (19%) dhe “të jetë më e sigurtë dhe të funksionojë pa probleme” (13%).

4.4 Procedurat e ankimit


Kjo pjesë e studimit përqëndrohet në procedurat e ankimit. Të intervistuarit u janë përgjigjur pyetjeve lidhur me lehtësinë e procedurave të ankimit, nëse kishin marrë ndihmë nga stafi i QKR-së, si dhe për mënyrën sesi ishin trajtuar ankesat e tyre.

Grafik 24: Procedurat e ankimit (n=64)




Procedurat e ankimit janë vlerësuar si të lehta dhe shumë të lehta nga shumica e të intervistuarve (69%). Shumica dërmuese e të intervistuarve në zyrën qendrore të QKR-së (82%) mendojnë se është e lehtë dhe shumë e lehtë të ankoresh.

Grafik 25: A ofroi stafi i QKR-së ndihmë/mbështetje të mjaftueshme? (n=37)



Shumica e të intervistuarve (75%) u shpreh se stafi i QKR-së iu kishte ofruar mbështetje të mjaftueshme për të vijuar procedurat e ankimit.

Grafik 26: Mënyra e trajtimit të ankesave nga stafi i QKR-së (n=64)



Shtatëdhjetë e shtatë përqind e të intervistuarve i cilësuan procedurat e ankimimit të QKR-së si të mira ose shumë të mira. Për këtë tregues, të intervistuarit i vlerësuan më mirë sportelet e QKR-së në bashki se sa zyrën qendrore të QKR-së.

PYETËSOR MBI PERFORMANCËN E QKR-së NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE

Unë, I/e nënshkruari/a _____ deklaroj se përfaqësoj Partnerët-Shqipëri, një organizatë jo-fitimprurëse. Unë jam këtu sot për të mbledhur informacion mbi performancën e QKR në ofrimin e shërbimeve, si pjesë e një studimi. Ky studim po bëhet në emër të Programit Prag të Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë II, e administruar nga Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar e SHBA (USAID). Ju lutemi, përgjigjuni këtyre pyetjeve të thjeshta që kanë për qëllim të përmirësojnë punën e QKR-së. Ju siguroj që informacioni i dhënë dhe opinionet tuaja do të mbeten konfidenciale.

I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Data e intervistës					
Kodi i intervistës					
Gjinia e të intervistuarit			Mashkull <input type="checkbox"/> Femër <input type="checkbox"/>		
Emri i plotë i kompanisë, për të cilën bëhet aplikimi (Nëse është person fizik, emri i individit shënohet vetëm nëse jepet në mënyrë vullnetare)					
Informacioni i kontaktit për kompaninë/personin fizik		Qyteti	Tel	E-mail	Adresa e internetit
Vendi i zhvillimit të intervistës dhe koha					

1. Përse keni ardhur sot këtu?

Për të marrë informacion **Bëni vetëm pyetjet 15-16d**

Për të dorëzuar një aplikim? **Shko tek pyetja 4**

Për të marrë përgjigje/çertifikatën e aplikimit tim **Vazhdo tek pyetja 2**

Për të depozituar një ankesë **Drejtoni vetëm pyetjet 17-21a**

Për të depozituar bilancin **Drejtoni vetëm pyetjet 12-16d**

2. Pas sa kohë morët përgjigje për aplikimin që bëtë (d.m.th., marrjen e çertifikatës së NIPT-it, çertifikatën e aprovimit, dokumentin e ekstraktit)? (Vendosni shenjë tek njëra nga kutizat)

Brenda ditës 1 ditë 2-5 ditë 1-2 javë

2-4 javë Më shumë se 1 muaj

3. Nëse më shumë se 1 ditë, cila ishte arsyeja që ju dhanë te sporteli për zgjatjen e procedurës? (Vendosni shenjë tek njëra ose më shumë kutiza)

Qaq zgjat procedura Aplikimi ishte jo i plotë Kështu më tha sportelisi

Më thanë që duhej më shumë kohë për ta aprovuar atë

Të tjera / Specifiko: _____

4. Për ç'loj shërbimi (shërbimesh) po aplikoni apo morët çertifikatën / përgjigjen sot? (Vendosni shenjë tek njëra ose më shumë kutiza)

Regjistrim fillestar	<input type="checkbox"/>	Korigjim të dhënash	<input type="checkbox"/>
Ndryshim të dhënash në regjistrim	<input type="checkbox"/>	Verifikim emri	<input type="checkbox"/>
Çregjistrim	<input type="checkbox"/>	Aktivizim aktiviteti	<input type="checkbox"/>
Rezervim emri	<input type="checkbox"/>	Pezullim aktiviteti	<input type="checkbox"/>
Për të marrë një ekstrakt të thjeshtë	<input type="checkbox"/>	Lëshim çertifikatash	<input type="checkbox"/>
Për të marrë një ekstrakt historik	<input type="checkbox"/>	Të tjera*	<input type="checkbox"/>

* Ju lutem specifikoni llojin e shërbimit _____

5. Morët një vërtetim kur paraqitët aplikimin?

Po Jo

6. Ç'loj biznesi është biznesi juaj? (Vendosni shenjën tek kutiza përkatëse)

Person fizik	Shoqëri e thjeshtë	Shoqëri tregtare (kolektive, komandite, sh.p.k., Sh.A.)	Degë dhe/ose zyrë përfaq. i një shoqërive të huaja	Shoqëri dhe union i kursim / kreditit	Shoqëri e bashkëpunimit të ndërsjellë	Subjekt tjetër
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

7. Cila është lidhja juaj me këtë biznes? (Vendosni shenjën tek kutiza përkatëse)

Individ (pronar)	Person i autorizuar, jo jurist	Jurist i brendshëm	Jurist i lirë/konsulent	Studio ligjore përfaqësuese e këtij biznesi
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

8. Në cilin rreth ndodhet biznesi juaj (Zyra qendrore)? Specifikoj rreth in _____

8a. (Nëse nuk është i njëjtë me rrethin në të cilin po intervistoni): Përse zgjidhet pikërisht këtë zyrë të QKR-së për t'u regjistruar? (Plotësoni njërën nga kutizat).

Është pranë vendndodhjes së biznesit tim Kisha edhe punë të tjera këtu
Unë banoj këtu

Më thanë nëpunësit e taksave Më adresuan punonjësit e Bashkisë
Sporteli këtu kryen punë më të mirë

Tjetër / Specifiko: _____

II. INFORMACION PËR PERFORMANCËN E QKR-SË

(Tani do t'ju drejtoj disa pyetje në lidhje me përvojën tuaj gjatë procesit të regjistrimit)

Part II.1

9. A ishin të qarta procedurat e aplikimit ?

Po Jo

9a. Nëse Jo, çfarë ishte e paqartë? (Vendosni shenjë tek njëra kutizë).

E gjithë procedura e regjistrimit Si të aplikojta
Ç'lloj forme biznesi të zgjidhja

Përse të paraqisja autorizim Përse të paraqisja ID e themeluesve
Çfarë dokumentash duheshin paraqitur

Informacioni në lidhje me regjistrimin për qëllime taksash

Informacioni në lidhje me regjistrimin për inspektoratin e punës

Tjetër(specifiko)_____

10. Sa herë ju desh të vizitonit zyrën e QKR-së për të përfunduar procedurën (referoju nr.4) (Vendosni shenjë tek njëra kutizë).

një herë dy herë tre ose më shumë herë

10.a Nëse ju është dashur të vini më shumë se një herë, cila ishte arsyeja që ju dhanë për ardhjen tuaj përsëri ? (Vendosni shenjë tek një ose më shumë kutiza).

Të marr çertifikatën/përgjigjen e aplikimit Sistemi nuk punonte

Nuk kishte energji elektrike

Zyra ishte mbyllur Të dhënat e paraqitura ishin të paplota

Të dhënat e paraqitura ishin të gabuara Kështu më thanë

Rasti ishte kompleks dhe kishte nevojë për më shumë kohë për t'u proceduar

Dosja e biznesit nuk gjendej në sistem

Të tjera / specifikoni _____

11. Sa ju desh të paguanit për shërbimin e marrë? (Vendosni shenjë tek njëra kutizë).

100 lekë më shumë se 100 lekë

11a. Nëse paguat më shumë se 100 lekë, cila ishte arsyeja? (Vendosni shenjë tek njëra kutizë).

Nuk kisha kohë për të marrë kusurin

Sportelisi nuk kishte të holla për kusur

Sporteli ofroi shërbim të veçantë ose me përparësi

Të tjera /specifikoni: _____

12. Sa kohë shpenzuat sot për të marrë shërbimin tuaj tek sporteli i QKR? (gjithë koha që nga momenti i mbërritjes)

Më pak se 30 minuta 30-60 minuta 1-2 orë

2- 3 orë Më shumë se 3 orë

12.a Nëse keni shpenzuar më shumë se 30 minuta, cilat ishin arsyet? (Vendosni shenjë të paktën tek njëra kutizë)

Kishte radhë të gjatë Sistemi nuk punonte

Sportelisi nuk ishte në vendin e punës

Ishte ndërprerë energjia

Të tjera /specifikoni: _____

13. Si e krahasoni kohën e shpenzuar për të kryer aplikimin e sotëm me përvojat e mëparshme në QKR, nëse keni aplikuar më parë? (Vendosni shenjë tek njëra kutizë).

Më pak kohë se hera e kaluar më shumë kohë se hera e kaluar
e njëjta kohë
e pavlefshme për këtë rast

14. Si do ta vlerësonit në përgjithësi nivelin e shërbimeve të ofruara nga stafi zyrës / degës së QKR?

1 Të keq 2 disi 3 i mirë 4 shumë i mirë

Part II.2

15. A e konsideroni informacionin e dhënë nga zyra e QKR-së të mjaftueshëm? Po Jo

16. Cila është mënyra më e mirë për të marrë informacion rreth aktivitetit të QKR-në dhe procedurave të regjistrimit? (Vendosni shenjë tek njëra ose më shumë kutiza)

Broshura informuese/Publikime të QKR Faqja internetit QKR
Zyra e tatimeve Media
Zyrat e informacionit të Bashkisë Miq
Tjetër(specifiko) _____

Nëse ai/ajo është përgjigjur “Faqja e internetit”, ju lutem, drejtojini pyetjet e mëposhtme:

16.a A e përdorni faqen e internetit të QKR? Po Jo

16.b A mendoni që informacioni i faqes së internetit të QKR është i mjaftueshëm dhe i dobishëm?

Po Jo

16.c A mendoni që informacioni i faqes së internetit të QKR është i qartë dhe lehtësisht i kuptueshëm?

Po Jo

16.d Si mund të përmirësohet faqja e internetit e QKR?

Duhet të ketë më shumë informacion

Faqe e internetit duhet përditësuar më shpesh

Duhet të jetë më e lehtë për të gjetur informacione të rëndësishme për të cilat

kam nevojë Duhet të jetë më e sigurt dhe të funksionojë pa probleme

Të tjera

Part III.

17. Sa e lehtë ishte për të bërë një ankesë?

1 Shumë e vështirë 2 E vështirë 3 E lehtë 4 Shumë e lehtë

18. A ju dha stafi i QKR ndihmë/mbështetje të mjaftueshme?

Po Jo

19. Sa të qarta dhe të kuptueshme ishin shpjegimet e tyre gojore dhe të shkruara?

1 Të paqarta 2 Disi 3 Të qarta 4 Shumë të qarta

20. Në përgjithësi, sa mirë u trajtua ankesa juaj?

1 Keq 2 Disi 3 Mirë 4 Shumë mirë

21. A jeni të informuar rreth procedurave të reja të QKR-së për ankesat? (takime tek Drejtori i Përgjithshëm, telefonata tek Drejtori i Përgjithshëm)

Po Jo

Nëse përgjigja është Po,

21a. A i keni përdorur ato?

Po Jo

22. A do të dëshironit të merrnit pjesë në një diskutim në grup më të madh në lidhje me performancën e QKR-së?

Po Jo

Nëse përgjigja është PO, plotësoni:

Emri i të intervistuarit		Numri i telefonit	
--------------------------	--	-------------------	--



REPORT

MONITORING THE PERFORMANCE OF THE NATIONAL REGISTRATION CENTER



Prepared by Partners Albania
Prepared for Millennium Challenge
